

## **Prof. Dr. Eriona Katro**

E punësuar me kohë të plotë si personel akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të së Drejtës civile të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Ka një përvojë pune 14 vjeçare si pedagoge dhe studiuese.

Pas diplomimit në Drejtësi në vitin 2006 pranë Universitetit Sapienza të Romës, studimet pasuniversitare dhe ato doktorale lidhen kryesisht me fushën e të drejtës së konkurrencës dhe të drejtës private evropiane. Gjatë studimeve të doktoraturës ajo është angazhuar si asistent pedagoge pranë Departamentit të së Drejtës së ekonomisë në Universitetin “Sapienza”, të Romës.

Ka mbrojtur titullin akademik Profesor në vitin 2015 dhe Profesor i Asociuar në vitin 2012.

Fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë E drejtë e konkurrencës; E drejtë private evropiane dhe E drejta civile.

Ka shërbyer në pozicione drejtuese pranë Albanian University, ku ka mbajtur dhe postin e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale si dhe postin e ZëvendësRektorit. Ka marrë pjesë në hartimin e dokumentacionit për hapjen e disa programeve të ciklit të dytë dhe të tretë pranë këtij Institucioni.

Ajo është autore e një sërë punimesh shkencore të paraqitura në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe artikujsh shkencorë të botuar në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Ka qenë anëtare e Bordit shkencor të disa konferencave me karakter kombëtar apo ndërkombëtar.

Zonja Katro ka punuar edhe si eksperte në hartimin e projekt-ligjit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Shqipëri. Gjithashtu ajo ka eksperiencë si vlerësuese e programeve të studimit në arsimin e lartë, pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Aktualisht është titullare e lëndëve “E drejtë e Konkurrencës e BE-së” në programin Master profesional në “UE Business law” dhe “E drejtë private evropiane” në Master të integruar në Drejtësi.

Ajo po punon për tekstin “E drejtë private evropiane” për programin Master i integruar në drejtësi dhe është e angazhuar në dy projekte kërkimore.